

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -XI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 NËNTOR 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Në fillim të mbledhjes Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë mbajti një minutë heshtje në nderim të heroit të Kosovës Enver Zymberi.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin e tij dhe të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë jo për ta goditur kryetarin e komunës apo koalicionin, por për të na bind neve e qytetarët e Komunës së Vushtrrisë se çka po ndodh në të vërtetë me këtë keqqeverisje për të cilën kam thënë në fillim të formimit të kësaj qeverie komunale nëse mbani mend se kjo qeveri është një qeveri e humbësve të bashkuar dhe këso qeverie të humbësve të bashkuar Vushtrria nuk ka pasur kurrë në historinë e saj. Kryetar dhe ju anëtarë të koalicionit, dua të ju rikujtoj se asnjëherë në mandatin 10 vjeçar të qeverisjes së PDK-së, qeveria e PDK-së nuk ka ngatërruar datën e çlirimit dhe flijimin e shumë dëshmorëve, martirëve e kategorive tjera të rënë për liri, kjo qeveri e çoroditur ka filluar të ngatërrojë edhe ditën e çlirimit të Vushtrrisë e të Kosovës, postimi në portale dhe facebook me titull: "Festojmë njëvjetorin e çlirimit të Vushtrrisë" tregon çmendurinë dhe nivelin e kësaj qeverie, por reagimi qytetar përmes komenteve besoj se i ka dhënë një leksion këtij koalicioni të humbësve të bashkuar. Qeveria e PDK-së nuk ka pasur kurrë asnjë akuzë, asnjë dyshim dhe asnjë përfolje nga qytetarët e Komunës së Vushtrrisë as nga pozita, e as nga opozita për korrupsione, haraç ndaj bizneseve e qytetarëve e as për keqqeverisje për Kryetarin e komunës z.Bajram Mulaku dhe

përgjithësisht për qeverinë komunale. Unë do dëshiroja të ishte kështu edhe për qeverinë aktuale. Kryetar ne PDK-ja për dekada të tëra jemi angazhuar me sinqeritet për të kontribuar dhe ndihmuar përpjekjet për shtetndërtim në Kosovë. Ne jemi angazhuar me përkushtim në kultivimin e parimeve të qeverisjes së mirë, transparencës, dhe llogaridhënës. Për më tepër, ne në Vushtrri kemi qenë shumë aktivë në denoncimin e çdo të keqeje korruptive po edhe kemi bërë përpjekje për të luftuar përçarjet, për çka historia ka dëshmuar se mund të ketë pasoja katastrofale në qeverisjet e papërgjegjshme. Ne gjithashtu jemi angazhuar aktivisht, e nganjëherë edhe në dëmin tonë, në krijimin e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit mes subjekteve politike dhe grupeve tjera të interesit. Ne besojmë se ky ishte proces bazë për sigurimin dhe rikthimin e besimit të ndërsjellë, i cili do të na sillte lirinë e të shprehurit, dhe mendimit ndryshe, bashkëpunim mes subjekteve politike, bashkëpunim mes institucioneve, bashkëpunim mes bizneseve, dhe kushteve të favorshme për zhvillimin e proceseve demokratike në komunën tonë. Duke parë se kjo qeveri nuk ka parime, llogaridhënie, transparencë dhe respekt institucional me mirësjellje, ju kërkujmë të rishikoni përpjekjet dhe politikat tuaja ndaj qytetarëve, opozitës, qeverisë së kaluar dhe kryetarit z.Mulaku. Ne jemi thëllësisht të shqetësuar për tentativën dhe qasjen tuaj lidhur me njëvjetorin e proklamatës “festimit të ditës së çlirimit të Vushtrrisë”, përfshirë këtu disa deklaratat tuaja që nga marrja e pushtetit, sado të paqëllimshme të janë ato, mund të prodhojnë efekte tejet të rrezikshme dhe të dëmshme, jo vetëm për raportet pozitive-opozitive, por edhe mund të rrezikojnë gjithë angazhimin tonë 20 vjeçar drejt respektit dhe kulturës që ka pasur mes subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend. Prandaj, ju bëjmë thirrje që të përmbaheni nga veprimet karrieriste po edhe demagogjike, deklaratat e njëanshme në mënyrë që të ruani kredibilitetin e rolit e pozitës kryetar komune. Ju kërkujmë të rishikoni politikat e qeverisjes me Komunën e Vushtrrisë, duke marrë parasysh se të gjitha politikat e juaja nuk janë në harmoni me interesat dhe kërkesat e qytetarëve, pasi qytetarët janë të lodhur nga mungesa e progresit dhe premtimet e thyera në të cilat kanë besuar deri më tani. Ne ju bëjmë thirrje që të siguroheni se të gjitha veprimet tuaja kontribuojnë në një trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve pa dallim se cilit subjekt politik i përkasin, në mënyrë që të shmanget rreziku i uljes së mbështetjes popullore për politikëbërësit dhe qeverinë komunale, si një qëllim nacional dhe i shumëpritur ndër shekuj, si dhe kundër-reagimet tona. Kryetar ka shumë përfolje nga qytetarët, deputetët e stafi komunal lidhur me korrupsionin, haraçin ndaj bizneseve, keqpërdorimin e buxhetit, lidhjen e kontratave (marrëveshjeve) të dëmshme e kundërligjshme, emërimeve politike siç është rasti me kompaninë “Uniteti”, punësime partiake e të kundërligjshme, kurdisje tenderësh për familjarë të drejtorëve, nepotizëm madje edhe gjenetik, këto janë preokupime të të gjithëve andaj pyeti: A janë të vërteta këto dukuri negative dhe të dënueshme apo kemi të bëjmë me perceptim; a kemi të bëjmë me këto dukuri si sistem apo është në stadin fillestar. Sot kam vendosur që vetëm të kërkoj përgjigje lidhur me këto dyshime që i potencova dhe edhe qytetarët edhe ne deputetët presim që sot kryetari po pse jo edhe koalicioni të jep sqarime dhe të zotohet para nesh dhe qytetarëve se nuk do të lejohet të operohet me këto të këqija, të cilat e dëmtojnë buxhetin e me këtë edhe qytetarin, zhvillimin e qytetit po edhe ngulfat ambientin e favorshëm të të bërit biznes.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - duke vlerësuar se përgjigjet në pyetjet e tij ndaj qeverisë komunale nuk ishin të plota, kërkoi nga kryetari i komunës që t'i ofrohet marrëveshja e bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Kompanisë “Uniteti”, si dhe (faturat dhe pagesat), lidhur me këtë çështje, nënvizoi se nuk kërkon informatë për gjendjen e kësaj kompanie pasi ajo dihet, kurse përgjigjet i kërkon nga kryetari i komunës e jo nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Tutje përsëriti se kërkon po ashtu nga kryetari i komunës t'i ofrohet memorandum i bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri (faturat dhe pagesat). Dhe në fund kërkoi që t'i ofrohet lista

e shpërndarjes së materialeve të objektit të vjetër të komunës, si dhe vendimet e komisionit për shpërndarjen e inventarit të këtij objekti.

Melihate Basholli – anëtare e kuvendit - pyeti se mbledhja e kuvendit a transmetohet direkt në radio Vicianum.

Gresa Muli – anëtare e kuvendit - në emër të grupit të grave ngriti një çështje e cila lidhet me ditën ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave e cila u shënua me datë 25 nëntor. Pas një takimi që kisha me zyrtares për barazi gjinore morra statistikave të rasteve të dhunës në familje të paraqitura ku sipas statistikave nuk kemi rënie por prej tri vitesh kemi një numër përafërsisht të njëjtë. Ne si komunë duhet të angazhohemi më shumë që ky numër të ketë rënie dhe për këtë arsye propozoj të angazhohemi që në bashkëpunim me institucione tjera të formojmë Mekanizmin koordinues institucional kundër dhunës në familje. Kam informatë që para dy vitesh krijimi i këtij mekanizmi është iniciuar nga OSBE por nuk ka pasur gatishmëri nga disa prej palëve të parapara për të qenë pjesë e këtij mekanizmi. Unë kam siguruar dokumentin e nënshkruar nga koordinatori nacional për mbrojtje nga dhuna në familje i cili është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë me ç’ rast ky dokument obligon të gjitha komunat që të ndër marrin veprimet e caktuara në drejtim të zbatimit të kësaj Strategjie. Duke pasur parasysh edhe rastet e dhunës në komunën tonë që kanë përfunduar me fatalitet shpresoj për një angazhim të madh në këtë aspekt.

Nezir Klinaku – anëtar i kuvendit: ceku si shumë të nevojshme mbajtjen e një mbledhjeje solemne, në rastin e festës së flamurit dhe 21 vjetorin e daljes publike të UÇK-së.

Sami Istrefi – anëtar i kuvendit: potencoi se në materialin e pranuar nga kuvendi, për rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa, pyeti rreth shfuqizimit të vendimit në mbështetje të shkresës së MAPL-së, lidhur me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe se ky organ tash e 7 muaj funksionon jashtëligjshëm. Andaj shtoi se si ka kuptim që ky organ mjaft i rëndësishëm i komunës të mos plotësohet në barazinë gjinore, dhe që mbledhjet e rekomandimet e tij të jenë kontestuese, andaj për këtë shprehu nevojën që të kemi një shkresë nga MAPL-ja se a mund të merren vendime kapitale nga ky forum pasi institucioni i nivelit qendror ka kërkuar të shfuqizohet. Dhe pyeti se a kemi të drejtë t’i votojmë rekomandimet e komitetit në kuvend, pasi MAPL-ja këtë organ e ka shpallur të jashtëligjshëm. Në fund tha se në këtë formë po vjen deri te një situatë ku do të mund të shfuqizoheshin vendimet e kuvendit të komunës, të cilat janë në interes për qytetarët, ashtu edhe siç po ndodh disa vendime tani veç janë kthyer të kundërligjshme nga ana e tyre, andaj lidhur me këtë çështje ai kërkoi nga kryesuesi i kuvendit, që me anë të një shkrese t’i adresohet MAPL-së, ashtu që të konstatohet se Komiteti për Politikë dhe Financa, a ka legjitimitet pasi vendimi për themelimin e tij është kontestuar.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - njoftoi kuvendin lidhur me çështjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ku ceku se është ngritur një padi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me aspektin gjinor të komitetit në fjalë. Për këtë vlerësoi se nuk kemi ende një epilog gjyqësor dhe se deri në një vendim të gjykatës, vendimi i kuvendit lidhur me Komitetin për Politikë dhe Financa është në fuqi. Në fund ceku se pas vlerësimeve që do t’i bëjmë në zyrën ligjore të komunës dhe sekretarinë e kuvendit, do t’i dërgojmë një shkresë MAPL-së lidhur me këtë çështje.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - lidhur me vlerësimet e bëra prej disa anëtarëve të kuvendit që kanë të bëjnë me qeverisjen e Komunës së Vushtrrisë, ceku se është në dijeni se afër 13,000 qytetarë kanë votuar për kandidatin tjetër për kryetar komune dhe kjo është e evidente, për këtë ai e respekton zërin kritik e ndoshta edhe skeptik të këtyre qytetarëve. Kur bëhet fjalë për qeverisjen në komunën tonë, atëherë nuk duhet të mbështetemi në thashethemet por mbështetja duhet të jetë mbi fakte, dhe faktet janë që raporti i auditorit të përgjithshëm ka gjetur se Komuna e Vushtrrisë ka implementuar për 12% më shumë rekomandimet e auditorit të përgjithshëm. Pastaj KDI-ja, Demokracia Plus, por edhe

partnerët tjerë siç është USAID-i, deri në këtë moment që po flasim e kanë renditur Komunën e Vushtrrisë, si komunën me transparente në mesin e komunave të Republikës së Kosovës. Më tutje shtoi se organizatat ndërkombëtare, por edhe vendore (që janë kredibile), e kanë renditur komunën tonë si më të suksesshme në aktivitet e prokurimit publik, si dhe për transparencë në prokurim dhe shpenzimin e parasë publike. Për të gjitha këto vlerësime ekziston raporti, i cili do të jetë transparent për publikun, dhe të gjithë do të kenë qasje në të. Opozita në Komunën e Vushtrrisë kritikën e saj, por edhe akuzat nuk duhet t'i mbështesë në thashethemet e kafeneve, por në fakte dhe dokumente zyrtare. Lidhur me të gjitha këto ai u zotua se nëse ka informacione që secilido zyrtar i administratës se tij, ka bërë veprime të kundërligjshme apo veprime korruptive që inkriminohen si vepra kriminale ai do të jetë i pari që do të merr masa konkrete konform ligjit. Sa i përket marrëveshjes që ka komuna e Vushtrrisë me kompaninë "Uniteti" njoftoi se KRPP-ja ka konstatuar, se një marrëveshje e tillë është tërësisht ligjore. Sa i përket transparencës, qeverisja e Komunës së Vushtrrisë karakterizohet me një hapje në qasje të qytetarëve, në informacionet publike lidhur me punët e komunës, këtë e dëshmon fakti se Komuna e Vushtrrisë për herë të parë në historinë 20 vjeçare i bën publike të gjitha kontratat që ka me operatorët ekonomikë në faqen zyrtare të komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - përsëriti se nuk është qëllimi i opozitës që ta godasë kryetarin e komunës, por ai kërkoi nga ky i fundit që të deklarohet lidhur me përfoljet për korrupsion dhe marrje të mitos dhe ryshfetit nga ana e disa zyrtarëve publik të qeverisë në Vushtri. Përgjigjet e kryetarit të komunës janë vetëm fraza, ai në vend se të angazhohej me veprime konkrete, duke premtuar shpërbllim për ata të cilët raportojnë për korrupsion në komunë, ai justifikon sikur çdo gjë është në rregull edhe pse ai e di se gjërat nuk janë duke shkuar si duhet dhe për këtë askush nuk jep përgjegjësi. Pastaj vlerësoi se festimi i të ashtuquajturës datë e një vjetorit të "çlirimit të Vushtrrisë" është dashur të festohet në mënyrë të ndryshme, duke festuar njëvjetorin e drejtorëve praktikantë të komunës për faktin se ata pozitën e parë si vend pune në karrierën e tyre e kanë postin e drejtorit në komunë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – tha se kur është ardhur në krye të komunës, është betuar se do ta respektoj ligjin dhe vetëm ligjin dhe ky betim do të vlejë deri në ditën kur qytetarët e Vushtrrisë vendosin ndryshe me votën e tyre që ai nuk do të jetë kryetar i Komunës së Vushtrrisë. Lidhur me vlerësimet për keqpërdorime, shtoi se si grup, si parti serioze politike, opozitare iu sugjeroi që të kursehen nga thashethemet dhe akuzat e tyre eventuale t'i bazojnë në fakte sepse para fakteve heshtin të gjithë. Sa i përket të ashtuquajturës datë të "çlirimit" të Vushtrrisë, ai gjykoj se ai nuk është qëndrim i qeverisë së tij dhe nuk njeh datë tjetër përpos asaj që është zyrtare dhe që festohet çdo vit. Mandej përsëriti se USAID-i amerikan e ka nxjerrë komunën tonë si një ndër komunat më transparente në 38 komunat e Republikës së Kosovës. Në aspektin ekonomik komuna jonë ka filluar ta marrë veten dhe kjo mund të dëshmohej me rritjen e numrit të bizneseve që po regjistrohen çdo ditë. Në fund tha se qytetari e ka parë se si qeveriset në mënyrë transparente, ndërsa sa i përket asaj se kush ka vendosur haraç këtë gjë krejt e dinë, por ata nuk janë të qeverisë aktuale në Komunën e Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - tha se e mirëpret dhe e përkrah kritikën e cila ndodh në kuvend, por kjo duhet bëhet në saje të fakteve dhe argumenteve. Pastaj shtoi se nëse ndonjë anëtar i kuvendit posedon fakte për ndonjë nga zyrtarët publik në lidhje me ndonjë aferë korruptive, atëherë ai fare mos të ngurrojë, por të gjitha t'i paraqesë para organeve kompetente.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - ceku se kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale e dinë fare mirë se ku e kanë problemin, por ata po heshtin dhe kjo heshtje po bëhet ose për ta mbrojtur koalicionin që e kanë ndërtuar ose janë të prekur nga lakmia e madhe për të përfutur. Ajo çka meriton të vlerësohet nga kjo qeverisje është ideja e

Drejtorisë së Arsimit për jetësimin e idesë për komunikim me email, mes shkollës dhe prindërve, por kjo ide është proklamuar dhe nuk është jetësuar. Ndërsa për të tjera të mira kjo qeveri dhe këta drejtorë nuk shquhen, ata shquhen vetëm me garën se cili drejtor po përfiton më shumë në mënyrë të kundërligjshme dhe kjo gjendje është në të vërtetë për keqardhje.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se kur po flasim për transparencën, atëherë duhet bërë të ditur se më datë 3.9.2018 Qeveria e Republikës së Kosovës, ka marrë vendim për shpronësimin e pronave në fshatin Galicë dhe Duboc për një projekt të një investitori polak për rimëkëmbjen ekonomike të minierës së magnezitit, në këtë kontekst pas diskutimit publik që është mbajtur me datë 4.10.2018 banorët e fshatit Galicë iu janë drejtuar institucioneve kompetente, por edhe kryetarit të komunës me një ankesë, por ende banorët nuk kanë marrë një përgjigje. Në shkresën e marrë nga zyra e kryetarit të komunës shkruan që ankesa i është dërguar Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – duke u bazuar në rubrikën televizive ku është bërë fjalë për minierën në fshatin Galicë, vlerësoi se nuk ndihet mirë kur sheh që një anëtar i këtij kuvendi del kundër një investimi prej shatë (7) milionë eurove, në një zonë që sot është livadh. Këto prona janë të atyre banorëve, por banorët nuk duhet të shkaktojnë pengesa në realizimin e këtij investimi. Kompania “Bisek” kompani polake, është prej kompanive shumë serioze dhe njëra ndër kompanitë më të mëdha në Evropë, e cila është licencuar nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineralëve. Tutje shtoi se ky projekt daton para se ai të vjen në krye të komunës, dhe ai u zhvillua gjatë kohës së kryetarit z.Mulaku, dhe se kompania e sipërcekur është e licencuar dhe e gatshme të investojë në një minierë e cila është mbyllur në vitin 1968. Mandej njoftoi se shpronësimin e pronave në atë lokalitet e bënë ministria gjegjëse e jo komuna, ndërsa për pronat që janë në pronësi komunale, komuna do të pranojë vlerësimin e bërë nga ministria e linjës, pasi për komunën është jetike që të ndodhë ky investim në kontekst të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Nëse ndonjëri nga pronarët e tokave private është i pakënaqur me vlerësimin e bërë sa i përket kompensimit për shpronësim, atëherë ai mund t’i drejtohet gjykatës kompetente për vlerësimin e pronës sipas kushteve të tregut. Në të kundërtën nuk është në rregull që nëpër media të dilet dhe të kundërshtohet investitori dhe të pengohet realizimi i këtij projekti, ndërkohë që papunësia në Kosovë është 60 %. Tutje ai shtoi se ai do të shkojë në Poloni që ta vizitojë këtë kompani dhe do të mundohet të inkurajojë që ky projekt të jetësohet. Në fund tha se Kosova vuan nga mungesa e investimeve dhe investitorëve të huaj, dhe kjo formë e ndjekjes dhe e përndjekjes së investitorëve nuk i shërben as qytetarëve e as vendit tonë. Lidhur me përgjigjen në shkresën e dërguar nga banorët, njoftoi se përgjigjja do të bëhet brenda afatit ligjor nga drejtoria kompetente.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se askush nuk është kundër investitorit dhe investimeve që ndodhin në komunën tonë, por ata janë kundër që të merren tokat e tyre dhe të mos paguhen ashtu siç e kanë vlerën ato dhe sipas kushteve të tregut. Pastaj ai vuri në theks se kryetari i komunës e di shumë mirë që tokat, të cilat shpronësohen me vendim të qeverisë, nuk i kthehen më pronarëve privat, dhe kështu banorët e atyre lokaliteteve do të çrrënjosen nga fshatrat e tyre, dhe konform kësaj ata do t’i kërkojnë të drejtat e tyre. Në kuadër të kësaj ai përsëriti se në ankesën që banorët i kanë dërguar kryetarit të komunës, nuk kanë marrë përgjigje as nga kryetari i komunës e as nga drejtori kompetent.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - njoftoi kuvendin se ka filluar të zbatohet vendimi, që prindërit e nxënësve të informohen përmes emailit nga muaji maj i këtij viti. Pastaj ceku se çdo muaj ai merr informata nga drejtorët e shkollave se sa emaile kanë shkëmbyer ata me prindërit rreth gjendjes së nxënësve, mirëpo numri i emaileve që dërgojë prindërit është shumë simbolik.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - arsyetoi rendin e ditës para anëtarëve të kuvendit, duke propozuar pikat shtesë që u inkorporuan në rend të ditës në pikën në të ndryshme. Ai veç e

veç arsyetoi pikat në të ndryshme, duke shpalosur interesin se përse ato pika duhet të futen në agjendën e mbledhjes për shqyrtim dhe aprovim. Ndërsa në fund arsyetoi rendin e ditës në përgjithësi dhe kërkoi që rendi i ditës të aprovohet në mënyrë unanime nga anëtarët e kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se në parim e mbështet rendin e ditës, por shprehu shqetësimin e tij për atë se shumica e materialeve të procedura në kuvend, nuk janë të firmosura nga kryetari i komunës kur dihet fakti se ky është një obligim ligjor. Pastaj shtoi se drejtorët e drejtorive dhe kryesuesi i kuvendit nuk mund të jenë propozues të pikave, dhe për këtë kërkoi një interpretim nga zyra ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - kërkoi të informohet se në cilën datë ka ardhur në komunë peticioni i banorëve të fshatit Akrahticë.

Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25.10.2018;
2. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës së komunës, në ofrimin e shërbimeve për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit;
5. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore në Komunën e Vushtrisë;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve, si dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrisë;
7. Shqyrtimi i Draft-Statutit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrisë me Nr.58/11 i datës 28.4.2011 (**shqyrtimi i parë**);
8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019 (**shqyrtimi i dytë**);
9. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimit i Informatës për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrisë;
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimet të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë me numër protokollit Nr.286/18 i datës 25.10.2018 për Ridestinimin e mjeteve financiare të komunës;
 - c). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për familjen e Fitim Saraçit.
 - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, pronë e cila evidentohet në emër të Mehmet (Qazim) Feratit;
 - d). Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Akrahticë, për konstatimin e gjendjes faktike të rrugës “Vullnetari i UÇK-së”;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25.10.2018

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtjet e tij në faqen 6 të procesverbalit të mbledhjes së kuvendit, ku ceku se gjatë diskutimit të drejtorit të DSHP-së është shtuar një zero më shumë tek çmimi i taksës për mbeturina.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25.10.2018, me vërejtjen e parashtruar nga anëtari i kuvendit.

2. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës së komunës, në ofrimin e shërbimeve për vitin 2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi Raportin e sistemit të menaxhimit të performancës së komunës, në ofrimin e shërbimeve për vitin 2017.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - kërkoi që të formohet një komision kuvendar për shikimin e gjendjes në terren pasi që në fshatin Breznicë është dëmtuar kanalizimi ku i njëjti është mbyllur dhe lagjet “Maloku, Segashi, Ajvazi, Prronaj, Haradinaj dhe Bregaj” të fshatit Stanoc i Epërm iu është rënduar jeta për shkak të kundërmimit të erës, dhe për këtë problematikë kërkoi të ofrohet një zgjidhje nga komuna.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi anëtarin e kuvendit se problematika të cilin ai e ngiti është në kompetencë të Komunës së Obiliqit dhe për këtë ata kanë kontaktuar këtë të fundit për ta zgjidhur këtë problem.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - tha se e vlerëson përmbajtjen dhe formën e hartimit të kësaj informate dhe ceku se gjatë vitit 2018 është bërë punë e mirë sa i përket mbrojtjes së ambientit. Janë larguar deponi ilegale, pastrimi i rrugëve bëhet rregullisht dhe personalisht më ndodh shpesh të has në makina duke pastruar rrugët gjë që më herët nuk më ka rastisur, mirëpo në informatë është cekur që sistemi i kanalizimit është rregulluar në pothuajse të gjitha fshatrat dhe kjo nuk qëndron për arsye se kemi shumë fshatra, të cilat nuk e kanë të rregulluar sistemin e kanalizimit dhe ballafaqohen çdo ditë me probleme në mungesë të kësaj.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se për sa i përket mbrojtjes së ambientit Komuna e Vushtrrisë është angazhuar mjaft shumë, kjo mund të dëshmohet me faktin se komuna ka ecur mirë në shtrirjen e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave për çdo ekonomi familjare dhe kjo është duke funksionuar mirë deri më tani. Mandej në kuadër të aksionit “ta pastrojmë Kosovën” janë eliminuar shumë deponi ilegale të mbeturinave dhe numri i tyre është afërsisht 10 në qytet dhe në fshatra. Lidhur me mbajtjen e pastërtisë së ambientit, ekziston një garë në nivel nacional ku komunat garojnë se cila do ketë më shumë aktivitete dhe sukses në mirëmbajtjen e ambientit dhe do të jetë përfituese e një granti, si dhe mund të themi se Komuna e Vushtrrisë është duke i prirë kësaj liste. Në kuadër të mbajtjes pastër të ambientit shumë shpejt do të procedohet në kuvend miratimi i një rregulloreje, ku do të specifikohet që parkingjet private të automjeteve duhet të jenë të shtruara në kubëza ose në ciment me qëllim që kështu të evitohet balta nga qyteti. Pastaj njoftoi se ndër ndotësit ambiental janë edhe tre gurëthyes që operojnë në komunën tonë, që kanë licencë nga niveli qendror e që në fakt komuna nuk përfiton, por dëmtohet nga këta operatorë ekonomikë. Në vazhdim ai shtoi se komuna në bashkëpunim me Gizin, kanë shpërndarë rreth 4500 kontejnerë mbeturinash falas dhe thuajse çdo fshat është pajisur me to dhe kjo do të ndikojë në përmasimin e gjendjes mjedisore. Krejt kjo e ka lehtësuar procesin e mbledhjes së mbeturinave, por ky nuk është proces perfekt për faktin se mungon sistemi i riciklimit të mbeturinave për shkak se komuna jonë nuk prodhon mjaftueshëm mbeturina dhe operatorët ekonomikë që merren me riciklimin

e mbeturinave nuk kanë ndonjë benefitet ekonomik që të investojnë në këtë fushë, andaj për këtë duhet të bëhen bashkë disa komuna dhe mbeturinat t'ju jepen një kompanie që merret me riciklimin e mbeturinave. Ai falënderoi punëtorët e kompanisë “Uniteti” për punën e bërë edhe përkundër kushteve të vështira në të cilat gjenden për faktin se ata nuk kanë një lokacion për ndërtimin e një objekti për riparimin e mjeteve motorike të tyre, nuk kanë zhveshtore dhe nuk kanë një objekt administrativ, për faktin se mbledhjen e kaluar kuvendi kishte marrë një vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një objekti për kompaninë “Uniteti”, por që MAPL-ja e kishte deklaruar si të kundërligjshëm këtë vendim.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se disa kompani që bartin peshë të rëndë të materialeve inerte të zhavorrit po shkaktojnë dëme të konsiderueshme nëpër rrugët e komunës dhe për këtë duhet të merren veprime konkrete. Tutje ai vlerësoi se në lagjen ku ai banon, është ndërpre procesi për vendosjen e ndriçimit publik, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe kjo është bërë nga prapavija politike, për faktin se ndriçimi është bërë sipas lagjeve të preferuara nga drejtori që i takon vijës së tyre politike. Lidhur me këtë ai kërkoi nga kryetari i komunës që të rishqyrtohet kjo paramasë dhe mos të veprohet politikisht sa i përket ofrimit të shërbimeve publike. Lidhur me konstatimin e anëtares së kuvendit znj. Muli për siç tha se në të kaluarën nuk janë mirëmbajtur rrugët, vlerësoi se konstatimet duhet të bëhen me fakte dhe jo vet të thuhet diçka sa për të thënë. Në këtë kontekst ai njoftoi se në të kaluarën qeveria Mulaku, ka kontraktuar rreth 80, 000.00 € me kompaninë “Uniteti” për larjen dhe fshirjen e rrugëve.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - tha se më së miri e di qytetari se si është bërë mirëmbajtja e rrugëve në të kaluarën. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave në fshatin nga ajo vjen, njoftoi se sistemi për menaxhimin e mbeturinave nuk ka qenë i shtrirë dhe banorët janë detyruar që në forma të ndryshme t'i pastrojnë ato, qoftë edhe duke i dërguar edhe në kontejnerët e qytetit.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se marrëveshja me gizin, por edhe shpërndarja e kontejnerëve për ekonomitë familjare është projekt i trashëguar nga qeveria Mulaku, dhe kjo është fakt, andaj askush nuk mund t'i përvetësojë projektet e tjetrit.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - kërkoi që të futet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave edhe shtëpia e tij, pasi atij nuk i ofrohet ky shërbim.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - në kundërpërgjigje ndaj kryetarit të komunës, ceku se në mbledhjen e kaluar në kuvend është votuar një vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për kompaninë “Uniteti” dhe jo vendimi për caktim lokacioni, dhe shtoi se si rezultat i shkeljeve esenciale ligjore ky vendim është deklaruar si i kundërligjshëm nga MAPL-ja. Pastaj ai ceku se të gjithë atë ditë kanë qenë në dijeni se ai vendim është në kundërshtim me ligjin, por kanë votuar pro, për faktin se kanë menduar që ministria këtë nuk do ta vërej dhe kështu kjo do të kalojë, por ka ndodhur e kundërta dhe për këtë shkak ai ka qenë kundër atij vendimi.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se të gjithë duhet t'i gëzohemi, të arriturve dhe shtoi se projektet për mirëmbajtjen e ambientit kanë ekzistuar në të kaluarën, janë sot dhe do të ketë edhe në të ardhmen kushdo që të jetë kryetar i komunës. E veçanta e krejt kësaj është se duhet të fokusohemi më shumë në gjelbërim të ambientit, mandej mbjelljen e drujve dhe ata të mbrohen për faktin se shumica që janë mbjellë në të kaluarën janë shkatërruar. Pastaj ajo vlerësoi se është imediate të fillohet të mendohet për hartimin e një strategjie komunale në vetëdijesimin qytetar për ambientin, ku këtu do të mund të inkuadroheshin shumë institucione, duke përfshirë shkollat.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - përsëriti problematikën e gjuajtjes së mbeturinave në fushën në mes fshatit Banjskë dhe Sllatinë, ku janë vendosur shumë mbeturina dhe ka ndodhur një ndotje enorme. Lidhur me këtë çështje kërkoi nga komuna që për atë problematikë të ketë një vëmendje të posaçme. Në këtë relacion ceku se në këtë lokalitet ka tre gurëthyes që

shkaktojnë shumë dëme, duke përfshirë pluhur, baltë dhe pesha të rënda të kamionëve që po i shkatërron rrugët. Për këtë çështje ai kërkoi kontrolle më të rrepta nga organet e inspektoratit, dhe shqiptim të sanksioneve.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - duke iu referuar parafolësës së saj, ceku se nuk është mirë të luhet me ndenja të punëtorëve, dhe që dikush të viktimizohet sikur është i pafajshëm kur dihet mirë fakti se çfarë politika janë ndjekur në të kaluarën lidhur me ambientin.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se çështjet mjedisore, janë shumë komplekse dhe shtoi se mirëmbajtja e ambientit nuk do të mund të jetë në nivelin e duhur nëse nuk kemi kolektor për trajtimin e ujërave të zeza. Tutje shtoi se një segment i cili nuk është trajtuar nga kjo informatë, është ai i ujit të pijshëm, për faktin se ka pasur shumë premtime se në gjashtëmuorin e parë të qeverisjes do të ketë ujë të pijshëm, dhe për këtë pyeti se cilat janë masat që janë ndërmarr për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm. Pastaj shtoi se rrjetin e sistemit të ujësjellësit qeveria e kaluar gati e ka përfunduar, por akoma nuk është bërë asgjë për lëshimin në funksion të ujësjellësit në fshatrat e komunës. Shumë qytetarë i kanë hapur kanalet për kyçje në linjën kryesore të ujësjellësit, por kryetari i komunës këtë informatë nuk e ka sepse nuk jeton në Vushtrri, andej i sugjeroi që të kthehet të bashkëjetojë me qytetarët e komunës së tij dhe të merret me problemet reale e praktike të qytetarit të komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - i mbështeti deklaratimet e anëtarit të kuvendit z.Bregaj lidhur me kanalizimin në fshatin Stanoc, dhe për këtë kërkoi një koordinim dhe veprim më efikas dhe të shpejt nga Komuna e Obiliqit dhe ajo e Vushtrrisë me qëllim që ajo gjendje e rëndë të sanohet. Pastaj kërkoi që në shpërndarjen e kontejnerëve të mbeturinave të futen edhe fshatrat që më herët janë pajisur me kontejnerë, siç është fshati Stanoc i Epërm, për faktin se disa familje atje nuk i kishin marrë këta kontejnerë dhe deri më tani ato ende nuk janë pajisur me këta kontejnerë dhe kjo po ndikon keq në menaxhimin e mbeturinave në këtë fshat. Sipas disa evidentimeve që janë bërë nga këshilli i fshatit del se 45 ekonomi familjare nuk janë pajisur me këta kontejnerë. Në fund duke reaguar lidhur me një shkrim të një portali, lidhur me kanalizimin në fshatin Stanoc i Epërm konkretisht në lagjen “Ajvazi”, ku vlerësoi se kjo lagje vërtet që nuk ka rrjet të kanalizimit dhe shtoi se në vitin 2016 qeveria e kaluar i kishte dhënë për këtë lagje 600 metra gyp për rregullimin e kanalizimit, por rregullimi i kanalizimit nuk ishte bërë asnjëherë.

Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, ku ndër të tjera shtoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka filluar me rregullimin dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në rr. “Bahri Kuqi”, ndërsa sa i përket lagjes për të cilën pandeh anëtari i kuvendit, ceku se ka qenë kërkesë e menaxherit të projektit të rrugës M2 që për shkak të pengesave që janë duke u bërë duhet të bëhet ndërprerja e ndriçimit dhe të bëhet një dislokim, apo të hiqen disa trupa ndriçues. Lidhur me këtë ai ceku se DSHP-ja nuk bën anime politike, kurse pjesa e rrugës të cilës i referohet anëtari i kuvendit do të rregullohet shumë shpejt.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi lidhur me disa projekte, të cilat ndikojnë në mirëmbajtjen e ambientit siç është mbjellja e drunjve dhe gjelbërimi i hapësirave publike, pastaj ceku se pastrimi i lumit “Llap”. Gjithashtu ceku se është nënshkruar kontrata për rregullimin e shtratit “Podrança” në saje të përfitimit të një donacioni.

5. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore në Komunën e Vushtrrisë

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - pasi e përgëzoi Drejtorinë e Inspektimeve, për heqjen e mallrave nga përdorimi, të mallrave me mbishkrimin që nuk e njohin Republikën e Kosovës dhe kjo e rrit sigurinë ushqimore. Pastaj ai e shtroi nevojën për angazhimin gjithëpërfshirës për stimulim e rritjes së prodhimeve vendore, sepse vetëm kështu rritet siguria ushqimore.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve, si dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë

Mehdi Bejtullahu, anëtar i kuvendit - ngriti çështjen e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, sidomos të atyre në sigurim të bizneseve private, të cilët nuk mund ta shfrytëzojnë të drejtën e pushimit dhe drejtat e tjera. Pastaj ai kërkoi nga inspektorati komunal që të kemi më shumë kontrolle sa i përket të drejtave të punëtorëve në sektorin privat.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se na gëzon fakti që kemi rritje të numrit të bizneseve, por megjithëkëtë jemi skeptik dhe të zhgënjyer me bizneset të cilat janë shuar që janë të evidentuar në numër 40, që në fakt nuk kemi një arsyetim se përse ndodh shuarja e tyre. Lidhur me këtë çështje ai propozoi që të ngritet një komision që do të merrej me konstatimin e fakteve se përse ndodh shuarja e këtyre bizneseve. Në vazhdim ai vlerësoi se bizneset nuk i deklarojnë të gjithë punëtorët, por megjithëkëtë trendi i zhvillimit ekonomik në sektorin privat është duke u përmirësuar.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - tha se duhet të kemi një bashkëpunim më të madh mes nivelit qendror dhe atij lokal me qëllim të ngritjes së nivelit të respektimit të drejtave të punëtorëve në sektorin privat.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se kjo informatë duhet të pasurohet edhe me të dhëna tjera lidhur me të punësuarit në sektorin publik dhe atë privat me qëllim që të kemi një tablo të përgjithshme lidhur me gjendjen e të punësuarve në komunë tonë. Tutje ai përgëzoi komunën për siç tha subvencionimin e kamatës për bizneset prodhuese e cila mundëson zhvillimin e bizneseve në komunë dhe ngritjen e zhvillimit ekonomik.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se të gjithë indikatorët tregojnë se ka filluar të ndryshohet klima e të bërit biznes në komunën tonë dhe rritja e motivit për ndërmarrësinë private në komunën tonë. Pastaj vlerësoi se me fillimin e zbatimit të projektit për zonën ekonomike në fshatin Lumadh do të kemi rritje dhe diversifikim të biznesit në komunën tonë. Në këtë kontekst shtoi se aktualisht në komunën tonë prijnë bizneset në fushën e tregtisë dhe kjo duhet të ndryshohet ashtu që të shtohet numri i bizneseve në fushën e prodhimitarisë. Andaj zona ekonomike do të jetë një inpakt shtesë në zhvillimin ekonomik të komunës. Subvencionimi i kamatës për bizneset është vetëm njëra nga masat e ndërmarra e cila ka dhënë efekt pozitiv në zhvillimin e bizneseve dhe kjo do të vazhdojë edhe viteve në vijim. Në fund ai tha se duhet të kemi një angazhim të përbashkët që t'i japim shtytje zhvillimit të biznesit dhe në tërësi zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

Miran Halili, drejtor i DEMZHR - tha se sipas të dhënave zyrtare në komunën tonë nga muaji janar e deri në muajin tetor në sektorin privat janë punësuar 320 punëtorë, duke mos përfshirë këtu projektet e dhënies së subvencioneve.

7. Shqyrtimi i Draft-Statutit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.58/11 i datës 28.4.2011 (**shqyrtimi i parë**)

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se qëllimi i ndryshimit të statutit të komunës në realitet është rritja e numrit të drejtorive komunale. Tutje shtoi se tek neni 2 lidhur me nenin 5 paragrafi 5.4 ku është propozuar të bëhet riformulimi si vijon: simbolet e komunës miratohen me më së paku 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit pas konsultimit publik gjithëpërfshirës. Neni 3 të riformulohet selia pasi është ndërruar lokacioni i komunës. Neni 4 propozohet të riformulohet, neni 9, paragrafi 9, pika 1 të riformulohet si vijon: Komuna e Vushtrrisë përbëhet prej vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve urbane, këtu nuk kemi kurrfarë ndryshimi. Tek neni 5 është propozuar që të hiqet paragrafi 2 i nenit 11, e që në fakt këtu propozohet të hiqet fuqia vendimmarrëse e kuvendit lidhur me themelimin e të

hyrave komunale dhe kjo kompetencë t'i jepet kryetarit të komunës e që kjo realisht nuk është e drejtë. Neni 6 lidhur me ndryshimin e nenit 15 propozohet që në rreshtin 4 në vend të fjalëve "duhet të merren parasysh" duhet të bëhet mund të merren parasysh nëse vlerësohet nga komuna se janë të arsyeshme dhe këtu nuk ka nevojë për ndryshim sepse mendimet e publikut duhet të merren parasysh. Tek neni 9 lidhur me ndryshimin e nenit 42 nuk ka ndryshime substanciale. Neni 11 dhe 12 gjithashtu nuk ka ndryshime përmbajtëse. Neni 16 lidhur me ndryshimin e nenit 71, komisioni statutar ka propozuar tri versione për të cilat do të vendoset nga kuvendi, nëse këto versione analizohen më hollësisht, atëherë versioni i parë drejtoritë themelohen nga kuvendi, këtu nuk kemi fare ndryshim për faktin se kjo është e rregulluar me statutin aktual. Gjithashtu versioni i tretë me më së paku me 2/3 e anëtarëve të kuvendit edhe kjo është e rregulluar me statutin në fuqi dhe këtu nuk kemi ndonjë risi. Ajo çka metët është vetëm një alternativë për çka mendon se kjo çështje është kompetencë ekskluzive e kuvendit sa i përket themelimit të drejtorive. Në disa komuna kemi raste që kryetari i komunës me vendim i ka themeluar drejtoritë komunale. Parimisht vlerësoi se komisioni nuk është dashur të jep fare versione lidhur me statutin, por vetëm është dashur ta jap një propozim, ndërsa anëtarët e kuvendit është dashur t'i japin propozimet tjera. Ky draft-statut është dërguar në kuvend në mënyrë të koklavitur, me qëllim që të shtyhet votimi i themelimit të drejtorive komunale, për faktin se ka pasur shumë premtime dhe tash kanë dal në sipërfaqe problemet e shumta të këtij koalicioni. Mandej në nenin 17 thuhet të hiqet neni 91 e që nuk duhet të ndodh, kjo për faktin se udhëheqësi i personelit duhet të konsultohet, këtu gjithashtu mendohet t'i merret fuqia ligjore çdo zyrtari në komunë dhe kështu gjithçka të jetë në kompetencë ekskluzive të kryetarit të komunës. Në fund tha se duhet të rishqyrtohet ky draft-dokument dhe i njëjti të silltet në kuvend për aprovim.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtjet dhe propozimet lidhur me draft-statutin duke shtuar se tek neni 2 është: Neni 5, paragrafi 5.4 të formulohet si vijon: Simbolet e komunës miratohen me së paku dy të tretat (2/3) e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës. Duhet: Neni 5, paragrafi 5.4 i statutit bazë të formulohet si vijon: <Simbolet e komunës miratohen me së paku dy të tretat (2/3) e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës> (kjo të ceket në të gjitha nenet, sepse është më e qartë për lexuesin); neni 4 Është: Neni 9, paragrafi 9.1 ridefinohet si vijon: Komuna e Vushtrisë është e përbërë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Duhet: Të mbetet siç është në statutin bazë (konsideroj se nuk kemi nevojë ta komplikojmë statutin, sepse edhe ashtu, Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave, e mbizotëron statutin. Qëllimi im në këtë rast është: Kryetarët e komunave të bëjnë presion përmes Asociacionit të Komunave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave.) Neni 7 Është: Neni 40, pas pikës (shkronjës) l) shtohen dy pika të reja si vijon: ll) Cakton lokacionin për ndërtim të objekteve me interes publik për komunën. m) Cakton lokacionin për varreza në territorin e komunës. Duhet: Neni 40, pika (shkronja) "ç" dhe pika (shkronja) "d" të statutit bazë riformulohen dhe pas pikës (shkronjës) "l" shtohen dy pika të reja si vijon: ç) Miratimin e hartës zonale të komunës; (formulohet) d) Miratimin e planit rregullues të hollësishtëm; (formulohet) ll) Cakton lokacionin për ndërtim të objekteve me interes publik për komunën; (shtohet) m) Cakton lokacionin për varreza në territorin e komunës; (shtohet) (konsideroj se statuti duhet të harmonizohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor), Neni 16 Është: Për nenin 71, komisioni propozoi tri (3) versione për të cilat do të vendoset nga kuvendi:

1. Drejtoritë komunale themelohen nga kuvendi i komunës.
2. Drejtoritë komunale i themelon me vendim kryetari i komunës.
3. Drejtoritë t'i themelojë kuvendi i komunës me një akt të veçantë, pas propozimit nga kryetari i komunës. Në këtë pikë jepen dy alternativa:

3.1. Me shumicën e anëtarëve të kuvendit të komunës, ose

3.2. Me së paku 2/3 e anëtarëve të kuvendit të komunës.

Duhet: Për nenin 71, të statutit bazë, komisioni propozoi dy (2) versione për të cilat do të vendos kuvendi:

1. Drejtoritë komunale me vendim i themelon kryetari i komunës;

2. Administratës të Komunës së Vushtrrisë i shtohen tri (3) drejtori:

2.1. Drejtoria për Përkujdesje Sociale;

2.2. Drejtoria për Bujqësi dhe

2.3. Drejtoria "X" (diçka për projekte).

(Këto sa i përket formulimit, ndonëse unë mendoj të shtohet një nen edhe dy nene të hiqen, në statutin bazë).

Neni "X" i statutit bazë i shtohet neni "X", dhe duhet të formulohet si vijon:

Qytetar i komunës është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës që jeton në Komunën e Vushtrrisë.

Neni "Y" hiqet neni 26 i statutit bazë (nuk ka ligj për referendumin).

Neni "Z" hiqet neni 52 i statutit bazë (asnjë ligj në fuqi nuk njih grup kuvendar).

Dhe krejt në fund dëshiroj që komisioni ta vërtetojë: A është në harmoni neni 48, paragrafi 48.2 me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - pasi e përshëndeti punën e komisionit statutar, shtoi se ky dokument i rëndësishëm komunal do të mund të plotësohej edhe me propozime tjera gjatë debatit publik. Pastaj vlerësoi se tek neni 6 lidhur me nenin 15 të statutit bazë, rreshti i katërt ku thuhet: në vend të fjalëve duhet të merren parasysh të shtohet edhe fjalia nëse janë në kompetencë të komunës, pasi që gjatë dëgjimeve publike qytetarët kanë adresuar probleme të cilat nuk kanë qenë në kompetencë të komunës, p.sh rrjeti elektroenergjitik çështje kjo e cila nuk është në kompetencë të komunës.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se nëse mbetet neni 52 i statutit bazë ku thuhet se grupet kuvendare përbëhen nga 3 e më tepër anëtarë që e përfaqësojnë të njëjtin subjekt politik, atëherë propozoi që këtu të shtohet edhe një fjali dy e më tepër subjekte politike të bashkuara brenda kuvendit ose anëtarë të pavarur.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të komunës ka bërë një punë të mirë në harmonizimin e statutit të komunës me aktet e tjera juridike. Pastaj ai vlerësoi se pas përfundimit të diskutimit publik, është mirë të vihet me një qëndrim të përbashkët të të gjitha subjekteve politike, lidhur me modalitetet e themelimit të drejtorive komunale, dhe atë ose të mbetet version aktual që drejtoritë të themelohen nga kuvendi i komunës ose që ato të themelohen me një akt të veçantë nga kryetari i komunës. Ai shprehu se e përkrah versionin e fundit që drejtoritë të themelohen nga kryetari i komunës pavarësisht se cili subjekt politik është në pushtet, kjo për faktin se secili kryetar e ka vizionin e vet për qeverisjen e komunës dhe kjo do t'i ndihmonte në realizimin e programit të tij qeveritar ashtu siç ai e sheh të arsyeshme. Mirëpo ai ndan këtë mendim personal, po në fund ai do të jetë mbështetës i vendimit që do ta merr grupi kuvendar i PDK-së.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se plotësimi dhe ndryshimi i statutit të komunës ka ardhur si domosdoshmëri e harmonizimit të këtij akti më të lartë të komunës, me aktet tjera juridike në fuqi. Për më tepër të gjithë kandidatët që kanë konkurruar për kryetar komune patën dhënë premtimin e për ridizajnimin e këtij dokumenti bazë për komunën. Pas shumë viteve duhet të kemi ristrukturim të drejtorive komunale, nëse Vushtrria krenohet me bujqësinë, atëherë domosdo duhet ta ketë Drejtorinë e Bujqësisë. Pastaj nëse komuna realizon gjitha këto projekte dhe bën planifikimin strategjik të projekteve kapitale për komunën, atëherë duhet të ketë një mekanizëm për përcjelljen dhe zbatimin e këtyre projekteve (drejtori për projekte). Pas diskutimeve publike gjithëpërfshirëse do të jepen edhe propozimet tjera dhe vendimin përfundimtar do ta marr kuvendi i komunës. Ligdhënësi kur ka dizajnuar

Ligjin për Vetëqeverisje Lokale po të kishte dashur të kufizonte kompetencat e kryetarit, do të përcaktonte se numri i drejtorive do të përcaktohet me statut, por këtë ligdhënësi nuk e ka normuar. Pastaj ai vlerësoi se çdo kryetar i komunës i cili garon për t'u bërë kryetar komune, ka një vizon politik sesi e sheh ndryshimin dhe kjo lidhet edhe me strukturën organizative për zbatimin e programit të tij. Në këtë kontekst ceku se komuna nuk duhet të ketë një rigjid, por duhet të ketë një statut i cili është adapt me rrethanat e reja në Komunën e Vushtrrisë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Statuti për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr.58/11, i datës 28.04.2018.

2.Diskutimi publik fillon nga data 3 dhjetor 2018 dhe zgjat deri më 24 dhjetor 2018.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4.Obligohet Komisioni Statutar i Kuvendit që si propozues i draft-statutit në fjalë të organizoj diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-statutit në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin dhjetorë 2018.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019 (shqyrtimi i dytë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për familjen e Fitim Saraçit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se është e vështirë për një familje kur ndodhin kësi lloj fatkeqësish, dhe ceku se ky vendim për ofrimin e ndihmës financiare për këtë familje duhet të aprovohet, dhe pasi që i njëjti do të zbatohet vitin e ardhshëm, atëherë mund të lihet mundësia që ai të ndryshohet më vonë që t'i ofrohet ndihmë financiare kësaj familjeje.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se kjo familje është në një gjendje të rëndë shpirtërore dhe sociale, pas fatkeqësisë që iu ka ndodhur. Andaj bëri thirrje që kjo kërkesë të aprovohet me qëllim që familjes Saraçi t'u dilet në ndihmë. Në fund ai falënderoi anëtarin e kuvendit nga radhët e LDK-së znj. Rrezarta Krasniqi për ndihmën e treguar për një familje nga fshati Beçuk, gjithashtu kërkoi që kërkesa në fjalë të aprovohet në mënyrë unanime.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës-fondi për subvencione dhe transfere, pozicioni “subvencione për rastet të veçanta” në Zyrën e Kryetarit të Komunës, për familjen e Fitim Saraçit nga fshati Bivolak , në shumën prej 2,000 € (dymijë euro).

2. Shuma e cekur në pikën 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të blerjes së banesës për familjen e Fitim Saraçit nga fshati Bivolak, i cila ka humbur jetën tragjikisht gjatë punimeve në firmën NN “Uka”.

3. Mjetet financiare të cekur në pikën 1 të këtij vendimi ndahen në emër të Hysen Ukës, pasi i njëjti ka siguruar pjesën tjetër të mjeteve financiare në vlerë prej 15,000 € (pesëmbëdhjetë mijë euro).

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimit i Informatës për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - tha se hartimi i kësaj informate është bërë në mënyrë të detajuar dhe kuptimplotë, për këtë e përgëzoi drejtorin e linjës.

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër protokollit Nr.286/18 i datës 25.10.2018 për Ridestinimin e Mjeteve Financiare të Komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit me nr.286/2018 i aprovuar me datën 25.10.2018 për ridestinimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë.

2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se afati për ridestinimin e mjeteve për projekte kapitale ka skaduar me datë 31.10.2018, andaj vendimi i tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, pronë e cila evidentohet në emër të Mehmet (Qazim) Feratit.

Ismet Gashi, zyrtar ligjor - kërkoi që në titull të këtij propozim-vendimi të futet fjala ndërrimi i destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për faktin se nëse mbetet kështu si është mund të kemi interpretim të ndryshëm sa i përket vendosjes së taksës ku për ndërrimin e përkohshëm të destinimit të pronës taksa është në vlerë prej 20%.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore; pjesës ideale të parcelës me Nr.2k-0 me kulturë ,bujqësore e klasës së pestë (5), Zona Kadastrale Sfaracak i Poshtëm me sipërfaqe të përgjithshme prej 18238m² nga e cila kërkohet për shndërrim 727.83m², Mehmet (Qazim) Ferati pronar i pjesës së ngastrës të cekur më lartë.

2. Qëllimi i lejit të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi është ndërtimi i objektit ekonomik-bujqësor „Fermë për Dhi”.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika e dytë do ta lëshojë dhe përcaktoj konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 në „b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr. 41/2006 përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Fletëtreguesi (i gjendjes faktike në komasacion) dhe kopja e planit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi ,Bujqësi ,Pylltari dhe Zhvillim Rural ,Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

d). Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Akrashticë, për konstatimin e gjendjes faktike të rrugës “Vullnetari i UÇK-së”

Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së - paraqiti sqarime hyrëse sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, duke dhënë informacionin se ekspertët e komunës kanë vizituar vendngjarjen e rrugës në fjalë dhe konform gjendjes faktike është bërë paramasa dhe parallogaria. Tutje tha se projekti për shtrimin e këtij trotuari në fshatin Akrashticë është zbatuar në terren. Por më vonë janë dalë probleme për faktin se banorët e atij lokaliteti janë ankuar dhe përmes peticionit kanë kërkuar që të ndërrohet ana e shtrimit të këtij trotuari. Pastaj njoftoi se në pjesën tjetër të rrugës ekziston një kanal kullues i cili ka një pjerrtësi dhe bartë ujëra të vrullshme dhe kjo ka qenë arsye që trotuari është shtruar ashtu siç është tani.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se shumica e banorëve të kësaj lagjeje qasjen e kanë nga ana e epërme e jo nga ana e poshtme kah është shtruar trotuari, ashtu që fëmija kur të qasen në trotuar, duhet ta kalojnë rrugën

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se peticioni është një instrument i ligjshëm i adresimit të problemeve. Në këtë kontekst sa herë që kemi peticione, atëherë nuk ndihemi mirë për faktin se dihet se diku kemi gabuar. Në këtë relacion duhet të kemi parasysh interesin e përgjithshëm qytetar dhe tani duhet të merret një vendim lidhur me këtë peticion.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se është obligim ligjor që peticionet të shqyrtohen nga ana e kuvendit, dhe kjo është bërë brenda afatit ligjor. Tutje shtoi se ekspertiza e bërë nga ekspertët edhe mund të qëndrojë, porse projektet në instancë të fundit bëhen për qytetarët dhe në këtë rast nëse nuk përfillen interesat e qytetarëve, atëherë çështjet përfundojnë duke bërë peticione. Andaj lidhur me këtë çështje vlerësoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet të marrë obligim që vitin e ardhshëm të bëjë sinjalizimin horizontal dhe vertikal, të vendos pengesat në rrugë dhe të shikojë mundësitë që vitin e ardhshëm të bëjë rregullimin e trotuarit edhe në anën tjetër të rrugës. Lidhur me rregullimin e trotuarit, qëllimi ka qenë që ky të vazhdojë deri te shkolla për shkak që nxënësit të mos dalin fare në rrugë, por ekspertët kanë konstatuar që për këtë nevojitet kosto shtesë dhe arsyeja është se kanë munguar mjetet financiare.

Agim Morina, përfaqësues i fshatit Akrashticë - në adresimin e tij para kuvendit, njoftoi anëtarët me problematikën në fjalë, e cila ka të bëjë me shtrimin e trotuarit në fshatin Akrashticë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - pyeti se deri në cilën fazë është zhvilluar ky projekt për realizimin e këtij trotuari, për faktin se nuk duhet të bëhet një projekt i cili shfaq rrezik për nxënësit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - tha se para se të hartohet një projekt për qytetarët, duhet të merret qëndrimi i banorëve të atij lokaliteti, më qëllim që t’u shmangemi gabimeve dhe problemeve që mund të shkaktojë më vonë pasoja.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se shqetësimi i qytetarëve të atij lokaliteti ka ndodhur shumë më herët, para se atje të bëhen punimet për shtrimin e atij trotuari, për këtë pyeti drejtorin se sa është vlera e mjeteve financiare për ndërtimin e trotuareve për vitin e ardhshëm, me qëllim që ky projekt të futet në listë për vitin 2019.

Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së - njoftoi se ky projekt fillimisht është nisur nga shkolla dhe ka vazhduar deri tek ura e një përroske dhe në këtë nuk ka pasur asnjë ankesë. Pastaj njoftoi se afër kësaj përroske ekziston një kanal në cep të rrugës që sjell ujërat atmosferike

dhe mbetjet tjera nga fushat dhe arat dhe kjo e dëmton këtë trotuar, si dhe kjo ka qenë arsye se përse është shtruar trotuari në anën e poshtme të rrugës.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se pasi të vendosen shenja e sinjalizimit dhe pengesat në rrugë, do të shikohet pas një kohe sa a do të ketë probleme në atë rrugë, dhe gjatë vitit të ardhshëm do të shikohet mundësia që edhe pjesa tjetër e rrugës të rregullohet.

Agim Morina, përfaqësues i fshatit Akrashticë - tha se punimet në këtë projekt janë të kualitetit shumë të dobët, dhe pas të reshurave atmosferike do të rritet niveli i ujit në atë lum dhe ekziston rreziku që kockat e vendosura në trotuar do t'i bart uji. Pastaj njoftoi se zhvillimi i shpejtësisë në atë rrugë është nga 80-110 km/h që pavarësisht kufizimit aty nuk respektohen shenjat e komunikacionit nga shoferët dhe kjo po shkakton rrezik për qytetarët (këmbësorët).

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se në bazë të informacioneve të dhëna nga përfaqësuesi i komunitetit, del se projekti në fjalë është realizuar në masën vetëm 10% dhe kjo është mjaft shqetësuese andaj për këtë propozoi që të formohet një komision për konstatimin e gjendjes faktike.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - propozoi Ilmi Azemin për anëtar të komisionit.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit - propozoi Agron Përçukun për anëtar të komisionit.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - propozoi Ymer Haradinajn për anëtar të komisionit.

Teuta Aruçi Shartari, anëtare e kuvendit - propozoi Basri Menxhiqin për anëtar të komisionit.

Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit - propozoi Nezir Klinakun për anëtar të komisionit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni kuvendar për konstatimin e gjendjes faktike lidhur me rrugën “Vullnetari i UÇK-së” në fshatin Akrashticë në këtë përbërje:

- 1.1 Ilmi Azemi, (PDK);**
- 1.2 Agron Përçuku, (LDK);**
- 1.3 Ymer Haradinaj, (LVV);**
- 1.4 Basri Menxhiqi, (AAK);**
- 1.5 Nezir Klinaku, (LB);**

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë për detyrë konstatimin e gjendjes faktike të rrugës “Vullnetari i UÇK-së” në fshatin Akrashticë, si dhe do të adresoi shqetësimet e banorëve të cekur në peticon lidhur me rrugën në fjalë.

3. Pas përfundimit të këtij procesi, komisioni do të hartojë raport lidhur me të gjeturat në terren dhe të njëjtin do t'ia adresoj kuvendit të komunës në mbledhjen e muajit dhejetor 2018.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

d). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Arta Ymeri, anëtare e kuvendit - adresoi pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike të bërë nga banorët e fshatit Beçuk, lidhur me ndërtimin e një rruge në këtë fshat.

Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së - duke u përgjigjur në pyetjen e parafolësës njoftoi se për asfaltimin e rrugëve kompetente është Drejtoria e Urbanizmit.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi se kur bëhet fjalë për projektet kapitale, nga qeveria e kaluar, kanë trashëguar një listë të projekteve kapitale dhe se rr. “Naser Miftari” ka qenë rrugë e planifikuar për t’u rregulluar, ndërsa banorët e lagjes “Murati” kanë të drejtë sepse është bërë shtrimi i rrugës sekondare kurse rruga e tyre ka mbetur pa u asfaltuar.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - pyeti lidhur me shpenzimet e kryetarit të komunës, si dhe kërkoi informatë me shkrim lidhur me numrin e të punësuarve me kontratë mbi vepër nga data 1 janar 2018 e deri më sot, si dhe a ka prej tyre punëtorëve që iu është vazhduar kontrata mbi vepër edhe pas afatit prej 6 muajsh, ndërsa në informatë duhet të ceket edhe profesioni i këtyre të punësuarve me kontratë mbi veprën.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - kërkoi raport me shkrim lidhur me gjendjen e përgjithshme, të fabrikës për riciklimin e mbeturinave në fshatin Bukosh, (numrin e punëtorëve, pagesat, gjendjen e aseteve të kësaj ndërmarrje). Pastaj pyeti lidhur me vendimin e kuvendit 127/16 i datës 30.6.2016, i cili nuk është zbatuar në mandatin paraprak, në këtë rast bëhet fjalë për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, destinimi i pronës është tokë ndërtimore, e dedikuar për ndërtime kolektive.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - lidhur me pyetjen e parë të parafolësit, njoftoi se bëhet fjalë për një investim donacion nga Komisioni Evropian, ku ka participuar edhe komuna, Komuna e Vushtrrisë i ka humbur 18.000.00 €, për faktin se komuna i ka blerë pajisjet e Kinës, kurse në kontratë ka qenë e paraparë që pajisjet të blihen nga vendet e Bashkimit Evropian. Lidhur me këtë çështje njoftoi se lënda është proceduar në prokurori nga ana e komunës. Funkionimi i kësaj kompanie do të mund të ndodhte vetëm nëse i jepej një status ligjor kësaj ndërmarrjeje. Asetet e kësaj ndërmarrjeje janë donacion që menaxhohen nga komuna, por komuna nuk mund të zhvillojë veprimtari ekonomike me këtë kompani për faktin se ndërmarrjet sociale nuk janë të rregulluara me ligj në Republikën e Kosovës. Ajo çka ai mendon të bëjë me këto asete është që ato të vihen në funksion dhe shërbime të Kompanisë “Uniteti” në kundërvlerë të një qiraje simbolike.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - kërkoi që në rrugën mes shkollës profesionale “Bahri Haxha” dhe shkollës teknike të vendosen pengesa profesionale në rrugë për shkak se ka zhvillim të lartë të shpejtësisë së automjeteve.


Mbledhja përfundoi në ora 13:30.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

